

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË PUKË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Pukë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 29.05.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1206/9, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Beqir , Kryetar i Bashkisë Pukë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pukë është audituar nga KLSH dhe me shkresën nr. 581/9, datë 25.09.2012 ka dërguar 20 rekomandime masa organizative, zhdëmtimi dhe disiplinore, prej të cilave janë realizuar plotësisht vetëm 4 masa, 9 masa janë realizuar pjesërisht dhe në proces, ndërsa 7 masa nuk janë realizuar, me një nivel realizimi prej 20 %. Masat e zhdëmtimit nga 3,052 mijë/lekë të rekomanduara, janë realizuar pjesërisht ose janë në proces 792 mijë lekë (25%) dhe mbeten pa realizuar 2,260 mijë/lekë.

1.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë (strukturat e përcaktuara në programin e punës), të zbatojnë plotësisht të gjitha rekomandimet si masat organizative dhe të zhdëmtimit, të pazbatuara dhe ato të zbatuara pjesërisht e në proces, të rekomanduara nga KLSH, dhe urdhëruar sipas Urdhrit nr. 114, datë 10.10.2012 “Për zbatimin e rekomandimeve” dhe plan-veprimit të Kryetarit të Bashkisë duke ndjekur të gjitha procedurat administrativo-ligjore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor, *për arkëtimin e shumës debitore prej 2,260 mijë lekë.*

Menjëherë

2. Gjetje: Bashkia Pukë nuk ka miratuar aktet e brendshme administrative lidhur me caktimin zyrtarisht të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm.

Nuk janë hartuar dhe miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit, nuk janë ndjekur dhe nuk janë bërë raportime titullarit të njësisë publike për mekanizmat e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për menaxhimin e riskut, ndjekjen dhe raportimin e parregullsive e të mangësive që pengojnë realizimin e objektivave.

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pukë, të nxjerrë aktet administrative, për caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, të marrë masat e nevojshme dhe të ndjekë hapat e duhur ligjor, për instalimin dhe zbatimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm, si dhe vendosjen e mekanizmave të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, sistemet e monitorimit, raportimit, me synim garantimin e realizimit të objektivave të Njësisë në përmbushje të funksioneve ndaj komunitetit.

Deri më 30.09.2015

3. Gjetje: Bashkia Pukë dhe komisioni i marrjes në dorëzim të kamionit teknologjik tip “VOLVO”, me targë TR 8826 R, sipas procesverbalit të datës 17.10.2012, ka lejuar dhe marrë në dorëzim mjetin, në mospërputhje të disa specifikimeve teknike të përcaktuara në kriteret e prokurimit për atë mjet, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.1 Rekomandim: Komisionet e marrjes në dorëzim të aktiveve në Bashkinë Pukë, të marrin masa që marrjen në dorëzim të aktiveve, ta kryejnë sipas specifikimeve teknike dhe të dhënave të tjera të kontratës, duke i ballafaquar me gjendjen faktike të tyre në momentin e mbërritjes së mallit në magazinat e institucionit ose në përfundim të punës apo shërbimit të kryer.

Për këtë, të planifikohen dhe zhvillohen trajnime me punonjësit e caktuar në komisione lidhur me përvetësimin teorik dhe praktik të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë institucionale për këtë qëllim.

Në vijimësi

4. Gjetje: Nga auditimi mbi 6 praktika të pagesave të përzgjedhura, u konstatuan *shkelje të ligjshmërisë në zbatim të menaxhimit financiar, të procedurave në prokurimin publik dhe udhëzimeve të APP-së, si më poshtë:*

- Përlllogaritja e fondit limit për shërbimin e kërkuar, është kryer në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 654 datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm, nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat”, duke mos marrë për bazë indeksin e çmimeve sipas INSTAT-it, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse.

-Në përzgjedhjen e ofertuesve nuk janë patur parasysh destinacioni dhe aktiviteti, sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar. Kështu, janë evidentuar raste kur subjekti i zgjedhur si fitues me ofertën e paraqitur ka aktivitet “...grumbullim,përpunim, tregtim i produkteve bujqësore (gështhenjë, mollë etj.)

4.1 Rekomandim: Nga Komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, të merret në konsideratë mirë llogaritja e fondit limit, mbi bazën e argumenteve relevant ekonomike, të vlerësohet specifika e aktivitetit që kryen subjekti, sipas ekstraktit historik të regjistrimit tregtar. Të mos lejohen dhe të mos pranohen për të lidhur marrëveshje operatorë ekonomike që kryejnë funksione dhe aktivitete të cilat nuk përfshihen në qëllimin dhe destinacionin e kryerjes së shpenzimit, të përcaktuar në urdhrin e prokurimit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër shpenzimeve sipas kronologjisë, argumentohet nëpërmjet pagesave me bankën, mungesa e ligjshmërisë, në kryerjen e pagesave për subjektet ‘F–L....’ dhe ‘E... L’.

Kështu rezultoi se për të gjithë periudhën e audituar me këto subjekte janë kryer gjithsej 26 pagesa, me vlerën totale prej 4,548,184 lekë, që të konceptuara si *gjurma auditimi*, argumentojnë *mangësitë në menaxhimin e kësaj njësie publike*, mbasi mbartin elementët e *riskut* në përqendrimin e prokurimeve (blerje me vlera të vogla) tek i njëjti subjekt, edhe ky me dokumentacion jo të rregullt ligjor.

-Në rastin e subjektit fizik “F...-L...”, e pa regjistruar në Zyrën e Tatimit-Taksave të Bashkisë Pukë, konstatohet se janë kryer rreth 40% të shpenzimeve për blerjet me vlera të vogla nga buxheti vendor.

Për sa sipër, Autoriteti Kontraktor, në përzgjedhjen e këtij subjekti, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të cilësuar në ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në nenet 2, 4, dhe 12; ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe pika 4, neni 31 pika 1, germa “a”, neni 44, neni 45 dhe neni 46, pika 1, germa “b”; VKM nr. 1 datë 10.01.2007 dhe VKM nr. 32 datë 23.01.2013.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë dhe komisionet e blerjeve me vlera të vogla, të mallrave, punëve dhe shërbimeve, të vlerësojnë maksimalisht parimin e konkurrencës, duke mos u përqendruar përzgjedhja e kontraktuesve në pak (ose një të vetëm) subjekte fizike ose juridike, me synim eliminimin e risqeve të uljes së efektivitetit të përdorimit të fondeve të buxhetit vendor. Lidhur me këtë, të merren masa për evidentimin e origjinës së përzgjedhjes së subjektit “Fiqirete-Latifi”, saktësimin e regjistrimit si tatim-pagues, e të kërkohej prej tij likuidimi i të gjithë detyrimeve ndaj Bashkisë Pukë.

Në vijimësi

6. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se deri më datën 12.10.2011, shërbimi i “Pastrim, Gjelbërim, Varreza dhe Dekorim”, të Bashkisë Pukë, realizohej nëpërmjet Kontratës së sipërmarrjes nr. 9, datë 12.10.2010, me operatorin bashkimi i shoqërive “B...” shpk, dhe “R...” shpk dhe pas kësaj periudhe në vitet 2012, 2013 dhe 2014 ky shërbim u riorganizua dhe realizohet nga Sektori i

Pastrimit në Bashki, jo në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”.

6.1 Rekomandim: Bashkia Pukë të analizojë, llogarisë e përcaktojë saktësisht sipërfaqet mbi të cilat shtrihet shërbimi i pastrim gjelbërimit, zgjerimin e tyre, vënien në efience dhe llogarisë koston për njësi si dhe shpenzimet përkatëse të këtij shërbimi me synim rritjen treguesve të performancës, përgjegjshmërisë menaxheriale, sigurimin e parametrave mjedisor, si dhe përdorimin e fondeve financiare për pastrim, gjelbërim, varreza dhe dekor, me efience, efektivitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

7. Gjetje: Në procedurat e prokurimit në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, janë caktuar, punonjës në kundërshtim me kërkesat e germës “ç”, pika 2 Kreu V i VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është caktuar z. B.A. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve dhe anëtare znj. Lindita Prendi, specialiste e financës, të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e preventivave dhe të specifikimeve teknike të tenderëve të zhvilluar, që janë pjesë të dokumenteve të tenderit, gjë që bie në kundërshtim me aktin e përmendur më lart .

7.1 Rekomandim: Titullari i Autoritetit Kontrator të marrë masa që në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, të caktohen punonjës të nivelit drejtues, duke shmangur konfliktin e interesit.

Në vijimësi

8. Gjetje: Në procedurat e blerjeve të karburantit sipas urdhrave përkatës, ishte ngritur grupi i punës me 3 punonjës për caktimin e fondit limit dhe në çdo rast ishte mbajtur vetëm një procesverbal, ku miratohej fondi limit në vlerë monetare, pa hartuar preventiv për të përcaktuar sasinë e mallit që nevojitej për t`u blerë, çmimet referuese, etj.

Në dosjet e tenderit nuk ka asnjë dokument që tregon dhe argumenton nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit, të nevojshëm për institucionet shkollore dhe Bashkinë, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreun II pika 2 germa “c” e “ç” .

8.1 Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë masa për përdorimin me efikasitet të fondeve publike, të argumentojë domosdoshmërinë e kryerjes së prokurimit dhe të përcaktojë me përgjegjësi nga persona kompetentë (specialistë të fushës), nevojat e sasive të mallrave që do të prokurohen, leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen, duke përcaktuar hollësisht specifikimet teknike.

Në vijimësi

9. Gjetje: Njësia e Prokurimit e Bashkisë nuk ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin dokumentet:

-Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.

-Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listë pagesat e sigurimeve shoqërore.

-Makineritë e pajisjet e nevojshme për realizimin në kohë të prokurimit.

-Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme.

-Specifikimet teknike janë të përgjithshme.

-Licencë profesionale për tregtimin e karburantit;

-Certifikatë cilësie për karburantin diezel që do të furnizojë.

-Licencë profesionale për prodhimin e artikujve ushqimorë për njerëz, apo impiant për prodhimin e bukës.

9.1. Rekomandim: Njësia e Prokurimit e Bashkisë, në çdo rast të zbatimit të procedurave ligjore të prokurimit në dokumentet e tenderit të kërkojë, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas kërkesave ligjore.

Në vijimësi

10. Gjetje: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rastet e anulimit të tenderit, për mungesë konkurrence, nuk ka mbajtur procesverbal për hapjen e tenderit dhe nuk ka hartuar Raportin Përmbledhës, i cili duhej të përshkruante ecurinë e procesit të prokurimit publik të zhvilluar, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 12 pika 2, neni 52 pika 3 “Hapja e ofertave” dhe që ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO-së dhe të Njësies së Prokurimit .

10.1 Rekomandim: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në çdo rast, të zbatojë kërkesat ligjore, të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë, për procedurat e kryera në zhvillimin e tenderit, në përcaktimin e fituesit të kontratës. Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, duhet të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit, në zbatim të dispozitave të mësipërme.

Në vijimësi

11. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tenderë, rezultoi se në disa raste operatorët janë kualifikuar në mënyrë të parregullt, sepse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues, dhe konkretisht:

- Në tenderët e zhvilluar me objekt “**Blerje dru zjarri**”, në vitin 2013 dhe vitin 2014, operatori ekonomik “E..” sh.p.k., që është i njëjti, ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet kualifikuese dhe ofertën dhe nga KVO-ja është konsideruar e pranueshme, si dhe është kualifikuar, në një kohë që nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga operatori në rrugë elektronike rezultoi se kishte mangësi:

Mungesat e dokumenteve, përbëjnë shkak që operatori ekonomik të ishte s`kualifikuar. Në procedurën e dytë të prokurimit me objekt “**Blerje karburante**” për vitin 2014, në procesverbalin e mbajtur nga KVO-ja për hapjen e tenderit evidentohet, që në tender ka marrë pjesë me ofertën e tij operatori ekonomik “E---D.....” sh.a. me marzh fitimi 14 lekë/ litër pa TVSH. Nga ana e KVO-së ai është s`kualifikuar edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat për kualifikim të cilësuar në dokumentet e tenderit nga Njësia e Prokurimit, duke i kërkuar operatorit ekonomik sqarime për deklaratën e tij për vendndodhjen e pikave të karburantit, kur kjo nuk ka qenë pjesë e kërkesave për kualifikim.

Për sa më lart mbajnë përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

11.1 Rekomandim: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në plotësimin e tyre me dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

Në vijimësi

12. Gjetje: Bashkia Pukë në zbatimin e kontratave të furnizimit me karburant për vitet 2013 dhe 2014, në asnjë rast nuk ka ngritur komision për pritjen e mallit, siç e kërkon udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” pika 42 e 43 dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu VIII, pika 2/b; mosveprime këto që ngarkojnë me përgjegjësi titullarët e institucionit .

12.1 Rekomandim: Bashkia Pukë të ngriejë komision me urdhër të veçantë, me të paktën 3 specialistë të fushës, në rastet e marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim.

Në vijimësi

13. Gjetje: Bashkia Pukë, në regjistrin e projekt-planit të të ardhurave për vitin 2013, në shumën totale të planifikuar prej 17,043 mijë lekë, ka përfshirë edhe debitorët deri me 31/12/2012 në shumën prej 2,667 mijë lekë, duke e rritur padrejtësisht objektivin e planit të të ardhurave. Shuma debitore nuk mund të përfshihet në planifikimin e të ardhurave të vitit pasardhës, pasi këto detyrime kanë qenë të planifikuara për t`u realizuar dhe arkëtuar në vitet e mëparshme, si

detyrime të prapambetura të vitit 2012 e më përpara, detyrime të cilat subjektet janë të detyruara t'i likuidojnë.

13.1 Rekomandim: Bashkia Pukë, nëpërmjet Zyrës së Tatim-Taksave, të planifikojë saktë e analitikisht të ardhurat nga tatime taksat vjetore sipas ligjit dhe të parashikojë e ndjekë në një plan të veçantë detyrimet e prapambetura të të ardhurave, debitorë të viteve të mëparshme.

Në vijimësi

14. Gjetje: Nga auditimi i dosjeve të personave juridikë dhe personave fizikë, konstatohet se dosjet nuk ishin të inventarizuara, në moszbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat në RSH". Kështu, nuk ndodhen në dosjet përkatëse të subjekteve, por gjenden në praktika të veçanta, dokumentacioni si: njoftim-vlerësimet tatimore dhe deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor për vitin 2013, proces-verbalet për përcaktimin e sipërfaqes ndërtimore, faturat për arkëtim dhe dokumentet vërtetuese të likuidimit të detyrimeve tatimore, si dhe dokumentacioni i mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar, gjë që sjell si pasojë, krijimin e problematikave lidhur me plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve dhe ndjekjen e arkëtimit të këtyre detyrimeve në kundërshtim me Kreun XI, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime.

14.1 Rekomandim: Bashkia Pukë, Zyra e Tatim-Taksave, të plotësojë, përditësojë e mbajë dosjet me inventarin përkatës në, sipas ligjit, dhe indeksit përkatës të subjekteve tatim-pagues, përfshirë dokumentacionin vërtetues dhe justifikues si: njoftim-vlerësimet tatimore dhe deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor për vitin 2013, proces-verbalet për përcaktimin e sipërfaqes ndërtimore, faturat për arkëtim dhe dokumentet vërtetuese të likuidimit të detyrimeve tatimore, dokumentacionin procedural të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar.

Deri më datë 30.07.2015

Gjetje: Në dosjet e subjekteve juridike "H-T-P"), FAF sha dhe "B..." sh p k, nuk ndodhen dokumentet e pronësisë nga ZVRPP, me sipërfaqen e shërbimit mbi të cilën llogaritet e vendoset taksa e ndërtesës, pra nuk është evidentuar sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore, sipas planimetrive të kateve. Gjithashtu nga ana e Zyrës së Tatim-Taksave, nuk ishte ngritur komisioni i verifikimit të pasurisë së paluajtshme, për të kryer matjen në vend të sipërfaqes së ndërtimit; mangësi e mosveprime këto në moszbatim të nenit 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

15.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë, Zyra e Tatim-Taksave, të caktojë komision të verifikimit të pasurisë së paluajtshme, të kryejë matjen në vend të sipërfaqes së ndërtimit, sipas planimetrive të kateve dhe sipërfaqes tjetër ndërtimore, për subjektet juridikë tatim-pagues: "H-T-P", FAF sha dhe "B....." shpk, si dhe të bëhet rivlerësimi tatimor i taksës e ndërtesës, për këto subjekte tatim-pagues. Për diferencat e rezultuara nga rivlerësimi tatimor, të merren masa për vjeljen e menjëhershme.

Deri më datë 30.07.2015

16. Gjetje: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të subjekteve persona fizikë tatim-pagues, u konstatua se në dosjet e subjekteve fizike Zamir Xhaferraj dhe Habibe Zenuni, nuk ndodhen dokumentet e pronësisë nga ZVRPP. Për të përcaktuar saktësisht sipërfaqen ndërtimore dhe taksa e ndërtesës është vendosur mbi bazën e një dokumentacioni inekzistent, ku nuk evidentohet sipërfaqja e përgjithshme sipas planimetrisë dhe/ose numrit të kateve.

Për sa më sipër, nga ana e Zyrës së Tatim-taksave nuk ishte ngritur komisioni i verifikimit të pasurisë së paluajtshme, për të kryer matjen në vend të sipërfaqes së ndërtimit, në moszbatim të nenit 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

16.1 Rekomandimi: Zyra e Tatim-Taksave, të marrë masa duke ngritur komisionin e verifikimit të pasurisë së paluajtshme, për të kryer matjen në vend të sipërfaqes së ndërtimit, sipas planimetrisë dhe/ose numrit të kateve e sipërfaqes tjetër ndërtimore, për subjektet fizike Z.Xh dhe H.Z.

Të rivlerësohen dosjet që disponon Zyra e Tatim-Taksave Pukë, (persona fizikë e juridikë) dhe të plotësohen këto dosje me dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur saktësisht taksën e

ndërtesës, dokumentacion nga ZVRPP Pukë me planimetri të sakta ose proces-verbal të komisionit të verifikimit, ku të jetë përcaktuar saktësisht sipërfaqja ndërtimore, mbi bazën e së cilës të llogaritet taksa e ndërtesës. Të bëhet rivlerësimi tatimor për rastet kur është dëmtuar interesi financiar i Bashkisë Pukë.

Deri më datë 30.07.2015

17. Gjetje: Mbështetur në të dhënat e marra prej Zyrës së Tatim-Taksave, rezulton se gjendja e debitorëve në fund të vitit 2014 paraqitet në **vlerën prej 9,381,827 lekë**, si të ardhura të munguara për Bashkinë Pukë, me një rritje prej 3,845 mijë/lekë (ose 41 %) krahasuar me vitin 2013. Kjo shifër detyrimesh është tepër e lartë, dhe është sa 87 % e realizimit faktik të të ardhurave për vitin 2014.

17.1. Rekomandim: Nga Zyra e Tatim-Taksave, të merren të gjitha masat për arkëtimin e plotë prej subjekteve debitorë, të të gjithë detyrimeve të prapambetura, të evidentuara në shumën e përgjithshme prej **9,381,827 lekë** deri më datën 31.12.2014, të mbartura nga viti 2012 e në vitet e mëparshme dhe për vjeljen e tyre nga ana e Bashkisë Pukë të ndiqet hapat ligjore si më poshtë:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë, në të cilat subjektet debitorë kanë çelur llogaritë e tyre rrjedhëse, urdhrat e bllokimit të këtyre llogarive në banka.

b-Ti dërgohet Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme) urdhrat për vendosjen e barrëve hipotekare dhe/ose barrëve siguroese mbi pasuritë e paluajtshme. Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet).

c- Ti dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet).

d-Në rast se subjektet debitorë, edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në banka, të vendosjes së barrëve hipotekare dhe/pse siguroese në ZVRPP dhe në DRT, sipas njoftimeve zyrtare, nuk paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 04.12.2014, pasi t'u vendosen masat administrative gjobë e barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë kalendarike, *të vendosen masat për sekuestrimin dhe konfiskimin e mallit dhe mbylljen e aktivitetit*, në zbatim të neneve 93 dhe 131, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Deri më datë 31.12.2015

18. Gjetje: Nga Bashkia Pukë, në bazë të VKM nr. 417, datë 08.06.2011, ishte përgatitur procedura dhe kishte përfunduar regjistrimi në ZVRPP Pukë, i vetëm 12 objekteve si pronë e Bashkisë Pukë, nga 491 gjithsej të miratuara sipas vendimit të KM, *duke mbetur jashtë regjistrimit 479 pasuri*.

Në bazë të vendimit Nr. 816 datë 04.06.2008, ishte mbajtur procesverbali datë 28.07.2008, ndërmjet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Pukë dhe Bashkisë Pukë ku ishte bërë dorëzimi i pronave në pronësi të kësaj Bashkie me sipërfaqe prej 1865 ha fond pyjor dhe kullësor e përbërë sipas kategorisë të përdorimit të territorit.

Bashkia Pukë për pyjet dhe kullotat e marra në dorëzim kishte përgatitur dokumentacionin për regjistrimin në ZVRPP Pukë dhe e ka depozituar plotësisht këtë dokumentacion, sipas vërtetimit të kësaj zyre, lëshuar me datë 28.03.2011, por deri më sot *nuk ishin të regjistruara parcelat me pyje dhe kullota në ZVRPP Pukë*.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.11.2001, me Udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e Qeverisjes Vendore”, VKM nr. 417, datë 08.06.2011 “Për miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Bashkisë Pukë të Qarkut Shkodër”, si dhe VKM nr. 816 datë 4.06.2008 “Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Pukë”.

18.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, të marrë masa, të ndjekë procedurat dhe të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm, për regjistrimin

në ZVRPP Pukë të 479 pasurive të kaluara në Bashkinë Pukë me vendimin KM nr. 417 datë 8.06.2011, si dhe të merren masa për regjistrimin në ZVRPP, të 61 pasurive gjithsej në 1865 ha fond pyjor dhe kullor sipas VKM nr. 816 datë 4.06.2008, si dhe të bëhen hyrje dhe të kontabilizohen këto asete dhe të përfshihen në bilancin e vitit 2015,

Deri më datë 31.12.2015

19. Gjetje: Prej auditimit të ushtruar Bashkinë Pukë, rezultoi se nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidentimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullorore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), shtrirë në territorin e juridiksionit të Bashkisë Pukë. Mungon e nuk është bëra mbajtja, evidentimi, administrimi balancimi i fondit kulloror, mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kulloror”, neni 5, pika 2 germa “b”, “Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, “Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kulloror”, neni 14, “Planet e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”.

Bashkia Pukë nuk ka lidhur kontrata për dhënie me qira të pyjeve, gjithashtu për vitet 2013 dhe 2014, nuk evidentohet asnjë m³ dru, apo lëndë punimi a material drusor tjetër për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit dhe nuk evidentohen të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve, nuk raportohet e nuk përfshihet me shifra një gjë e tillë. Për vitet 2013 dhe 2014, nuk janë krijuar të ardhura nga tarifat e përdorimit të kullotave dhe kositje, nga kapaciteti i kullotave në juridiksionin e kësaj Bashkie (llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”).

Si konkluzion, nga mos hartimi i planit përkatës të menaxhimit, mos parashikimit për dhënie me qira, mos përfshirja në buxhetet përkatës të secilit prej viteve si në pjesën e të ardhurave ashtu dhe të shpenzimeve, kanë sjellë si pasojë zhvillimin jo të qëndrueshëm të pyjeve e kullotave .

19.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë masa për kryerjen e inventarizimit kadastral pyjor me synim evidentimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullorore, bimore, aftësinë e funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), si dhe mbajtja, evidentimi, administrimi e balancimi i fondit kulloror, shtrirë në territorin e juridiksionit të Bashkisë Pukë.

Të përfundojë hartimi i planit të menaxhimit e mbarështimit në pyje, kullota e livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash, pra vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve dhe përdorimin me kursim (ekonomicitet) të këtyre burimeve financiare, në funksion të arritjes së objektivave që i ka vënë vetës kjo Bashki, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave dhe rritjen e sasisë, numrit dhe nivelin e shërbimeve në komunitet.

Deri më datë 31.12.2015

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se përzgjedhja e punonjësve të policisë nuk ishte bërë me komision, në kundërshtim me nenin 11, të Rregullores nr. 823, datë 11.04. 2003, dhe efektivat e policisë janë emëruar nga Kryetari e Bashkisë Z. Beqir Arifaj, në përputhje me nenin 3, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për përcaktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore”. Policët janë me arsim të mesëm dhe mbi moshën 27 vjeç, në mospajtim me “Rregulloren e Brendshme “TIP”, të miratuar me urdhër të përbashkët nr. 823, datë 11.04.2003 të dy ish-ministrive. Nuk është krijuar komisioni për emërimin e inspektorit të policisë, sipas përcaktimit të nenit 5, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, i ndryshuar.

U konstatua se nuk ka programe vjetore, plan operativ të përbashkët me zyrën e tatim taksave për organizimin e vjeljes së të ardhurave të Bashkisë dhe me strukturat e tjera të kësaj njësie publike. Në përmirësimin e cilësisë së punës së tyre punonjësit e policisë nuk i janë nënshtruar asnjë kualifikimi apo trajnimi, në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, të ndryshuar.

Për periudhën e auditimit Janar 2013- Dhjetor 2014, nga Policia e Bashkisë Pukë janë vendosur për të dy vitet 33 gjoba me vlerë 740 mijë lekë, por që nuk rakordoheshin me zyrën e financës dhe më e keqja është se nuk ka asnjë gjobë të arkëtuar.

20.1 Rekomandimi: Policia Bashkiake të hartojë programe vjetore dhe plane operative të përbashkëta me Zyrën e Tatim Taksave për organizimin e vjeljes së të ardhurave të Bashkisë dhe me strukturat e tjera të këtij institucioni publik, ne funksion të detyrave dhe funksioneve që kryejnë strukturat në fjalë. Të zgjerohet gama e subjekteve mbi të cilat vendosen gjoba, si: furgonat pa licencë, ndotja e ambientit, mos regjistrimi i subjekteve, mos pagimi i detyrimeve tatimore, ndërtimet pa lejë, prishja e rrugëve, trotuareve, etj. Të bëhet rakordimi me Zyrën e Financës dhe të arkëtohen të gjitha shumatat e vendosura si gjobë.

Punonjësit e policisë t'i nënshtrohen kualifikimeve apo trajnimeve, sipas ligjit me synim përmirësimin e cilësisë së punës së tyre.

Deri më datë 30.07.2015

21. Gjetje nga auditimi: Në auditimin me zgjedhje të dokumentacionit të bankës, për periudhën objekt auditimi viti 2013-2014, lidhur me rregullshmërinë e zbatimit të kriteve ligjore, në përdorimin e fondeve nga të ardhurat e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve (NUK) Pukë, konstatohet se në disa raste është urdhëruar kryerja e shërbimeve dhe blerja e mallrave, në favor subjekteve të pa licencuara për prokurimet përkatëse, siç mund të përmendim rastin kur subjekte të licencuara si “Bar-Kafe” kanë marrë përsipër riparimin e rrjetit kryesor të Ujësjellësit në Bashkinë Pukë ose “Fruta-Perime”, për blerjen e materialeve kancelerike, pra nga një ofertues pa kapacitetet teknike dhe specialitetet e duhura.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar, në nenet 20, 23, 31, 44, 45 dhe 46, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, VKM nr. 32, datë 23.01.2013 si dhe Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 28.03.2013.

21.1 Rekomandimi: Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Pukë dhe Komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, të bëjë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë fitues, bazuar në kapacitetet e tyre tekniko-ekonomike dhe specialitetet e duhura sipas llojit të mallit, punës apo shërbimit të parashikuar në urdhrat e prokurimit. Shërbime të tilla si riparime të rrjeteve të Ujësjellësit, etj., duhet të kryhen nga vetë Ndërmarrja e UK, me burimet e saj të brendshme, sipas qëllimit për të cilin funksionon kjo ndërmarrje si shoqëri anonime, mbi bazën e rregullores dhe statutit të saj.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për kryerjen e pagesave për prokurimet me blerje në vlera të vogla në Ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizimeve sha Pukë, konstatohet se:

a. Preventivin për zërat e punimeve të kërkuara, e ka llogaritur dhe ka miratuar Titullari i Autoritetit Kontraktor, ish-Drejtoresha e NUK Pukë, znj. Lindita Hyseni.

b. Situacionin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera e ka konfirmuar përsëri ish-Drejtoresha e NUK Pukë, znj. Lindita Hyseni.

Këto veprime, janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

22.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë dhe Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizimeve sha në të ardhmen të zbatojë procedurat ligjore në prokurimet për blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve si dhe të zbatojë ndarjen ndërmjet proceseve të projektim-preventivimit, tenderimit, supervizionit, marrjen në dorëzim e kolaudimit e objekteve, mallrave, punëve apo shërbimeve.

Në vijimësi

A. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje: Bazuar në urdhrat nr. 8, datë 10.06.2013 dhe nr. 21, datë 26.12.2013, të lëshuar nga ish-Drejtori znj. Lindita Hyseni, është urdhëruar dhënie shpërblim për punonjësit e Ndërmarrjes së

Ujësjiellës Kanalizimeve, sipas listave me 8 dhe 20 punonjës në shumën gjithsej prej 265,000 lekë (65,000 +200,000), me arsyetimin se pagesat bëhen nga fondi i veçantë. Ky arsyetim nuk qëndron, pasi Ndërmarrja UK është shoqëri anonime dhe fondet për shpërblime miratohen pas konfirmimit të bilancit, në bazë të shpërndarjes së fitimit neto të realizuar për vitin përkatës. Ky urdhër është i kundërligjshëm në një kohë që NUK është planifikuar dhe rezulton vazhdimisht me humbje.

Në zbatim të këtyre urdhrave, sipas konfermave bankare datë 13.06.2013 dhe 27.12.2013, janë kryer pagesat për shpërblimin e 28 punonjësve në shumën total prej 238,500 lekë (58,500+180,000), sipas listë-pagesave të nënshkruara nga ish-Drejtori znj. Lindita Hyseni dhe Kryetari i degës Ekonomike znj. Lavdie Tërbuni. *Pagesa prej 238,500 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik*, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve Pukë, (Drejtoria Ekonomike) të kryejë kontabilizimin e **shumës 238,500 lekë**, si detyrim financiar në ngarkim të 28 punonjësve të kësaj ndërmarrje, të shpërblyer sipas konfermave bankare datë 13.06.2013 dhe 27.12.2013, të ndiqen hapat dhe procedurat administrativo-ligjore e të bëhet arkëtimi i vlerës nga 28 subjektet debitor, sipas konfermave bankarë dhe listë-pagesave përkatëse.

Deri më datë 30.09.2015

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me *Urdhër-shpenzimin nr. 288 datë 24.9.2013*, është kryer pagesa në shumën 68,000 lekë, në favor të subjektit “F.L”, për likuidimin e faturës nr. 36 datë 28.12.2012, për prokurimin me vlera te vogla për *Shpenzime për Pastrim bore rruga kryesore dhe dytësore*.

Nga kontrolli i ligjshmërisë në kryerjen e pagës për shpenzimin sa sipër, përveç të tjerave, rezulton se përlllogaritja e pagesës, nëpërmjet preventivit përkatës, për çmimin për orë/pune prej *4000 lek/orë pune*, është e pa bazuar ligjërisht, pasi sipas formulës së tarifës së pagesës për orë/pune të manovratorit, përcaktuar në germën “c”, pika 1, të VKM nr 654 datë 18.12.2002, me koeficientin “m” maksimal 160 lekë, rezulton *256,4 lekë/orë pune*.

Nga mos zbatimi i kriterëve ligjore për pagesat sa sipër, **rezultojnë pagesa të pa justifikuar për shërbimin e kërkuar**, në totalin e orëve të kronometruara sipas Procesverbaleve të datave 11 dhe 12 Dhjetor 2012, për gjithsej 17 orë pune, në shumën **63,641 lekë, si dëm ekonomik**.

Sa sipër bie në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 654 datë 18.12.2002, *“Për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm, nga organet shtetërore, në situata emergjente, të çdo mjeti privat”*.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Pukë, nëpërmjet Zyrës së Financës, të kryejë kontabilizimin e shumës **63,641 lekë**, si detyrim financiar në ngarkim të subjektit “F.L”, duke ndjekur hapat dhe procedurat administrativo-ligjore e të bëhet arkëtimi i vlerës nga subjekti debitor.

Deri më datë 30.06.2015

C. MASA ADMINISTRATIVE

c. 1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin, 15, pika c, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, i kemi kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për: anëtarët e Komisionit Vlerësimit të Ofertave dhe hartuesit e Dokumenteve të Tenderit, anëtarët e komisionit për blerjet në vlera të vogla dhe juristen e Njësisë së prokurimit të shoqërisë, si më poshtë:

1. z. E.K, jurist i Njesisë së Prokurimit për vitin 2013 dhe vitin 2014,
2. z. A.M, specialist, anëtar i Njesisë së Prokurimit për vitin 2013,
3. znj. F.B ekonomiste, anëtare e Njesisë së Prokurimit për vitin 2013,
4. znj. L.H, inxhinierë anëtare e Njesisë së Prokurimit për vitin 2014 dhe anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2013,
5. Znj. M.E ekonomiste anëtare e Njesisë së Prokurimit për vitin 2014, sepse në kundërshtim me nenet 23, 45 e 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, në dokumentet e tenderit mungojnë kërkesat kualifikuese që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, dhe përcaktimi i specifikimeve teknike për karburantin,
- 6. B.A, në pozicionin, Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2013 dhe vitin 2014.**

7. L.P në pozicionin anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2013.

8. A.A në pozicionin anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vitin 2014.

sepse në kundërshtim me pikën 3, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, rezultoi se në disa raste operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tenderë janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderëve, e konkretisht:

- Në tenderët e zhvilluar me objekt “Blerje dru zjarri”, në vitin 2013 dhe vitin 2014, operatori ekonomik “E.....-L....” sh.p.k., që është i njëjti, ka paraqitur në rrugë elektronike dokumentet kualifikuese dhe ofertën dhe nga KVO-ja është konsideruar e pranueshme, si dhe është kualifikuar, në një kohë që nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të paraqitur nga operatori në rrugë elektronike rezultoi se kishte mangësi:

- vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve fiskale, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, shprehet për detyrime në shumën 103,335 lekë.

- nuk është dokumentuar origjina e mallit, që do të furnizojë, nuk ka kontratë, apo licencë për shfrytëzim pylli dhe as ndonjë marrëdhënie kontraktore me subjekt tjetër që operon në këtë fushë e kërkuar në kërkesat e veçanta për kualifikim.

- nuk ka paraqitur dëshmi për furnizime të të njëjtës natyrë e kërkuar në kërkesat e veçanta për kualifikim.

- nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të konfirmuara nga organet tatimore.

Mungesat e më sipërme përbëjnë shkak që operatori ekonomik të ishte shkualifikuar. Në procedurën e dytë të prokurimit me objekt “Blerje karburante” për vitin 2014, në procesverbalin e mbajtur nga KVO-ja për hapjen e tenderit evidentohet, që në tender ka marrë pjesë me ofertën e tij operatori ekonomik “E...D.....” sh.a. me marzh fitimi 14 lekë/ litër pa TVSH. Nga ana e KVO-së ai është shkualifikuar edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat për kualifikim të cilësuar në dokumentet e tenderit nga Njësia e Prokurimit, duke i kërkuar operatorit ekonomik sqarime për deklaratën e tij për vendndodhjen e pikave të karburantit, kur kjo nuk ka qenë pjesë e kërkesave për kualifikim.

D. MASA DISIPLINORE

D.I. Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë Pukë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë, nga masa “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

1. z. S.Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore,

-për mos ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Pukë, nr. 114, datë 10.10.2012 “Për zbatimin e rekomandimeve”, së bashku me plan-veprimin përkatës.

2. B.A, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve,

-për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla, për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në nenet 2, 4, dhe 12, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet 20, 23, 31, 44, 45 dhe 46, VKM nr. 1 datë 10.01.2007, VKM nr. 32 datë 23.01.2013, si dhe Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 të APP-së.

-në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Marrjes në dorëzim të kamionit teknologjik tip “VOLVO”, për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12, pika 3, germat “dh” dhe “f” të Ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe pikat 43 e 44 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik

-për faktin e konstatuar se organizimi i shërbimit të pastrimit në Bashkinë Pukë, nëpërmjet Sektorit të Pastrimit, ka rezultuar in efektiv, pra me një kosto më të lartë në shumën 2,076,000 lekë, se në periudhën e mëparshme, në një kohë kur sipas të dhënave operative të Sektorit të Tatim Taksave dhe Zyrës së Gjendjes Civile, numri i bizneseve dhe numri i popullsisë është në rënie, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 2, nenin 4 pikat 9,14,19,23,24 dhe 24, nenin 12, dhe nenin 29, të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, me pasojë mbishpenzim fonde financiare në shumën 2,076,000 lekë .

3. znj. F.B Përgjegjëse e Sektorit të Financës,

-për mos ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Pukë, nr. 114, datë 10.10.2012 “Për zbatimin e rekomandimeve”, së bashku me plan-veprimin përkatës, mos kontabilizim të detyrimeve financiare për punonjësit dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë, lidhur me rekomandimet e KLSH-së, (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 25 deri 37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të prokurimit me Vlera të Vogla, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla, për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në nenet 2, 4, dhe 12, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet 20, 23, 31, 44, 45 dhe 46, VKM nr. 1 datë 10.01.2007, VKM nr. 32 datë 23.01.2013, si dhe Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 të APP-së .

4. znj. A.S ish- Përgjegjëse e Sektorit Juridik, juriste,

-për mos ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Pukë, nr. 114, datë 10.10.2012 “Për zbatimin e rekomandimeve”, së bashku me plan-veprimin përkatës.

-në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me Vlera të Vogla, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla, për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në nenet 2, 4, dhe 12, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet 20, 23, 31, 44, 45 dhe 46, VKM nr. 1 datë 10.01.2007, VKM nr. 32 datë 23.01.2013, si dhe Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 të APP-së.

5. z. I.K, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të prokurimit me Vlera të Vogla, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla.

6. H.D, Përgjegjës i Zyrës së Tatim-Taksave

7. M.E, ish- Përgjegjës i Zyrës së Tatim-Taksave

-për mos ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Pukë, nr. 114, datë 10.10.2012 “Për zbatimin e rekomandimeve”, së bashku me plan-veprimin përkatës,

-për problematikat e konstatuara gjatë auditimit të Zyrës së Tatim-Taksave:

-shuma debitore përfshihet në planifikimin e të ardhurave të vitit pasardhës, pasi këto detyrime kanë qenë të planifikuara për t'u realizuar dhe arkëtuar në vitet e mëparshme, si detyrime të prapambetura të vitit 2012 e më përpara, detyrime të cilat subjektet janë të detyruara t'i likuidojnë, e në të kundërt duhej ndjekur mbledhja forcërisht e tyre,

-për të gjitha rastet konstatohet se dosjet nuk ishin të inventarizuara, në moszbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat në RSH".

-dokumentacioni si: njoftim-vlerësimet tatimore dhe deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, për vitin 2013, proces-verbalet për përcaktimin e sipërfaqes ndërtimore, faturat për arkëtim dhe dokumentet vërtetuese të likuidimit të detyrimeve tatimore, si dhe dokumentacioni procedural i mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar, sipas Kreut XI, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime, nuk ndodhen në dosjet përkatëse të subjekteve, por gjenden në praktika të veçanta, gjë që sjell si pasojë krijimin e problematikave lidhur me plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve dhe ndjekjen e arkëtimit të këtyre detyrimeve,

-në dosjet e subjekteve juridike "HTP, FAF sha dhe "B..." sh p k, nuk ndodhen dokumentet e pronësisë nga ZVRPP, për të përcaktuar saktësisht sipërfaqen ndërtimore dhe taksa e ndërtesës është vendosur mbi bazën e një dokumentacioni të mangët (HTP), ose inekzistent (FAF sha dhe "Bekimi" sh p k) ku nuk evidentohet sipërfaqja e përgjithshme sipas planimetrive të kateve.

-në dosjet e subjekteve fizike Z.Xh dhe H.Zi, nuk ndodhen dokumentet e pronësisë nga ZVRPP, për të përcaktuar saktësisht sipërfaqen ndërtimore dhe taksa e ndërtesës është vendosur mbi bazën e një dokumentacioni inekzistent, ku nuk evidentohet sipërfaqja e përgjithshme sipas planimetrisë dhe/ose numrit të kateve.

Për sa më sipër, nga ana e Zyrës së Tatim-taksave nuk ishte ngritur komisioni i verifikimit të pasurisë së paluajtshme, për të kryer matjen në vend të sipërfaqes së ndërtimit, në moszbatim të nenit 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar,

-për moskryerje kontrole lidhur me grumbullimin e taksave e tarifave vendore, për lëshimin e kuponit tatimor, të dëftesës tatimore apo faturës së thjeshtë, si dhe regjistrimin e çdonjërit prej këtyre dokumenteve në librin e qarkullimit, për evidentimin dhe regjistrimin nga tatimpaguesit të blerjeve të realizuara për qëllimet e biznesit (rishitje, përpunim apo shpenzime të tjera), nëpërmjet dokumentacionit përkatës.,

-për moskryerje kontrolli të plotë në ambientet e tatimpaguesit mbi verifikimin dhe mbajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe regjistrimeve sipas përcaktimeve në udhëzimin e përbashkët,

-për moskryerje kontrole (sondazhe për matjen e xhiros) për çdo tatimpagues, me qëllim vlerësimin e qarkullimit të realizuar nga tatimpaguesi nëpërmjet kronometrimin,

veprime e mosveprime në moszbatim të pikës 10, të udhëzimit të përbashkët nr. 655/1, datë 06.02.2007.

-për faktin e evidentuar se në fund të vitit 2014 gjendja e debitorëve paraqitet me ***një vlerë prej 9,381,827 lekë, me një rritje prej 3,845 mijë/lekë (ose 41 %) krahasuar me vitin 2013.*** Kjo shifër detyrimesh është tepër e lartë, dhe është sa 87 % e realizimit faktik të të ardhurave për vitin 2014, dhe për vjeljen e këtyre detyrimeve nuk janë përdorur të gjitha format shteruese, deri në sekuestrimin, konfiskimin e mallit dhe mbylljen e aktivitetit dhe kallëzimet penale, veprime e mosveprime në moszbatim të neneve 93 dhe 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008" Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar .

8. znj. L.H, Përgjegjëse e Zyrës së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Për faktet e konstatuara se:

-Për mos ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Pukë, nr. 114, datë 10.10.2012 "Për zbatimin e rekomandimeve", së bashku me plan-veprimin përkatës,

- Nuk ishin të regjistruar parcelat me pyje dhe kullota në ZVRPP Pukë, në moszbatim të VKM nr. 500, datë 14.11.2001, me Udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e Qeverisjes Vendore”, VKM nr. 417, datë 08.06.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së Qeverisjes Vendore Bashkia Pukë të Qarkut të Shkodër”, si dhe VKM nr. 816 datë 4.06.2008 “Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Pukë”.

-Nuk ishte kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidentimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të Bashkisë Pukë. Mungon e nuk është bëra mbajtja, evidentimi, administrimi i bilancimit të fondit kullozor, mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullozor”, neni 5, pika 2 germa “b”: ”Pronësia”, neni 7: “Inventarizimi”, neni 8: “Regjistrimi”, neni 9: “Regjistri i Fondit Kullozor”, neni 14: “Planet e Mbarështimit” dhe neni 15: “Bimët Mjekësore”.

-Prej Bashkisë Pukë nuk disponohet kontratë për dhënie me qira të pyjeve dhe për vitet 2013 dhe 2014 nuk evidentohet asnjë m³ dru, apo lëndë punimi a material drusor tjetër për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit, për rrjedhojë nuk evidentohen të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve. Gjithashtu theksojmë se për vitet 2013 dhe 2014 nuk janë krijuar të ardhura nga tarifat e përdorimit të kullotave dhe kositja, llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”.

-Për nxjerrjen e urdhrave nr. 8, datë 10.06.2013 dhe nr. 21, datë 26.12.2013, të lëshuara si ish-Drejtor i Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve, ku është urdhëruar *dhënie shpërblim për punonjësit e NUK-së, sipas listave me 8 dhe 20 punonjës në shumën gjithsej prej 265,000 lekë (65,000 +200,000), me arsyetimin se pagesat bëhen nga fondi i veçantë. Ky arsyetim nuk qëndron, pasi NUK është shoqëri anonime, dhe fondet për shpërblime miratohen pas konfirmimit të bilancit, në bazë të shpërndarjes së fitimit neto të realizuar për vitin përkatës. Ky urdhër është i kundërligjshëm në një kohë që NUK është planifikuar dhe rezulton vazhdimisht me humbje.*

Në zbatim të këtyre urdhrave, sipas konfirmave bankare datë 13.06.2013 dhe 27.12.2013, janë kryer pagesat për shpërblimin e 28 punonjësve në shumën total prej 238,500 lekë (58,500+180,000), sipas listë-pagesave të nënshkruara nga ish-Drejtori znj. L.H dhe Kryetari i degës Ekonomike znj. L.T. **Pagesa prej 238,500 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik.**

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

-Për një rast, kur është urdhëruar kryerja e shërbimeve, në favor të një subjekti, person fizik me aktivitet “Fruta Perime”, për riparimin e rrjetit kryesor të Ujësjellësit në Bashkinë Pukë.

-Për preventivimin për zërat e punimeve të kërkuara dhe njëkohësisht miratuar si titullar i Autoritetit Kontraktor dhe njëkohësisht konfirmim të situacionit dhe marrjes në dorëzim të punimeve të kryera

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Praktika sa sipër është tërësisht e kundërligjshme dhe me mangësitë e konstatuara krijon premisa për shmangie të konkurrencës, dhe për më tepër shërbimi i afuar nga kjo firmë, nuk mundet të sigurojë standardet e kërkuara teknike.

-Për një rast, kur është urdhëruar pagesa në favor të një subjekti, person fizik me aktivitet “Bar Kafe”, për shërbimin e “Riparim kolektorit kryesor të KUZ”, për shumën në vlerë të shërbimit prej 138,300 lekë.

-Për një rast kur është urdhëruar pagesa në favor të subjektit F.Ç, person fizik me aktivitet “Tregtim fruta perime”, për shërbimin e blerjes së materiale kancelarie dhe bojëra .

Sa më sipër janë ofertues pa kapacitetet teknike dhe specialitetet e duhura.

Për sa sipër, janë shkelje të ligjshmërisë në moszbatim të:

- Ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në nenet 2, 4, dhe 12.

- Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, në nenet 20, 23, 31, 44, 45 dhe 46.

- VKM nr. 1 datë 10.01.2007, VKM nr. 32 datë 23.01.2013 si dhe Udhëzimi nr. 2 datë 28.03.2013 të APP, mbajnë përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Përgjegjësja e Degës së Financës.

Nga Bashkia Pukë, me shkresë nr.ska, prot, datë 17.06.2015, protokolluar në KLSH me nr.137/37 prot., datë 17.06.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Aleksander Papadimitri, Mirosh bogdo, Nefail Xhepehxiu dhe Vasillaq Peci, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT